




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VIII /2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 8(tetë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së
Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	31.08.2022
Ora:	10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Znj.Saranda Bajraktari	Të pranishëm të tjerë
Z.Selman Kolgeci	Z. Driton Maliqaj	Nënkryetarja e
Z. Flamur Bytyqi	Z. Xhevxhet Gashi	Komunës
Z. Urim Suka	Z.Edon Sadikaj	Media dhe qytetarë
Z. Kushtrim Kuçi	Z.Dardan Berisha	OSCE, LMT, KDI
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Bajram Basha	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi	Znj.Mevlude Kabashi	Z.Xheladin Sadikaj
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z.Alban Berisha	Znj.Laureta Tafaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Liridon Fandaj	
Z. Reshat Selimaj	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Lirim Qatani	Znj.Festë Kabashi	
Z. Aziz Bytyqi	Z.Herolind Limaj	
Znj.Sanie Kuçi	Znj. Jehona Rrafshi	
Rexhepaj		
Znj.Mimoza		
Bajrakatari		
Znj.Fidaije Kukaj		
Znj. Afërdita Morina		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi.

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimeve të çmimit “Ukë Bytyqi” ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01- Nr-016-20154 , të datës 30.03.2021 ;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës ;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alloimin e mjeteve nga fondi burimor (38),Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 në projektet kapitale ;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të Komunës ;**
- 7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e zyrës kombëtare të auditimit ;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit, i njofton me rendin e ditës dhe e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - ia jep fjalën Nënkryetares së Komunës.

Nënkryetarja - përshëndet të pranishmit.Përmes një deklarate që e lexoi në Kuvend, Nënkryetarja ka denuar rastin e dhunimit të së miturës në Ptishtinë.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit.Sa i përket këtij rasti, sot mbahet protestë në Prishtinë kundër dhunës ndaj grave.Kërkoj mirëkuptim nga ju që seanca të përfundoj sa më shpejt të jetë e mundur,ti përfundojmë të gjitha pikat në mënyrë që mos të lem anash asgjë dhe ti bashkohemi asaj proteste.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Urim Suka - përshëndetje për të gjithë.Ekzistojnë disa vërejtje në procesverbal, por vërejtja më theksore është qasja e rastit kur Kryetari i drejtohet asambleistët me ato fjalë që janë në video dhe reagimin.Fjalët e mia kur kam reagu ekzistojnë mirëpo fjalët e Kryetarit drejtuar asambleistes nuk ekzistojnë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Miratohet me vërejtje

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e propozimeve të çmimit “Ukë Bytyqi” ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që përbërja e komisionit është prej 5 anëtarëve. Kryesuesi i Kuvendit shkon me automatizëm, dy vin nga Kuvendi, dy nga ekzekutivi dhe një nga shoqëria civile. Hap debatin për propozimet.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit të AAK-së propozojmë Mimoza Bajrakatari.

Doruntina Zenelaj - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Bulëza Kuçi.

Nënkryetari - nga ekzekutivi propozojmë Enver Shabani ndërsa nga shoqëria civile Aida Kuçi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këta anëtar: Bexhet Kuçi, Mimoza Bajraktari, Bulëza Kuçi, Enver Shabani dhe Aida Kuçi.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për ndryshim - plotësimin e vendimit 01- Nr-016-20154 , të datës 30.03.2021 ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Shefket Kolgeci - pse e ka ndryshu vendimin KEDS-i, ku është arsyeja?

Avni Bytyqi - thotë që KEDS ka pas vështirësi me një lokacion për vendosjen e trafostacioneve dhe ka kërku që të dislokohej me një lokacion tjetër. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime rreth procedurave.

Selman Kolgeci - sa i përket kësaj pike, në parim pajtohem, por mendoj që kërkesat duhet të jenë më të detajuara. Fakti se në skicën të cilën e ka bashkangjitur njesia kërkuese po mungojnë koordinatat dhe krijojnë dilemma se ku saktësisht do të vendoset trafostacioni. Nëse nuk mund të bëhet ndarja dhe parcelizimi i parcelës, së paku të vendosen katër koordinata në skicë. Gjithëashtu dua të ngris shqetësimin e banorëve të rrugës “Rasim Kolgeci” në Popolan, rruga “Agushajt” , “Martirët e Vraniqit”, “Adem Kolgeci” dhe “Ukë Zekaj” por edhe pjesës më të madhe të fshatit Vraniq për prishje të shpeshta të rrjetit të vjetërsuar. E di që qeverisja komunale nuk është drejtpërdrejtë kompetente por kërkoj që kjo problematikë të futet në tema të diskutimit në takime të ndryshme në mes Komunës dhe KEDS-it.

Kryesuesi - në skicë janë të procesume edhe pikat.

Selman Kolgeci - janë katër pika, por nuk janë koordinata.

Avni Bytyqi - nuk mundet drejtorja e pronës me parapri para vendimit të Kuvendit. Nëse Kuvendi merr vendim, drejtorja e pronës ka për obligim ta zbatojë këtë vendim dhe del të vendos koordinata duke mos e penguar qasjen në rrugë.

Selman Kolgeci - unë nuk thash me dal me vendos koordinata. Unë thashë që KEDS-i drejtuar Drejtorisë së Pronës është dashtë me i vendos koordinatat dhe ato koordinata ne me i miratu dhe mandej me i zbatu në teren. Është gjë teknike.

Urim Suka - ne jemi për këtë vendimi dhe për mi dhanë mundësi qytetarëve që KEDS me e përmirësu veten e vet sepse problemet janë të mëdhaja.Unë kërkoj nga ju si qeverisje me identifiku probleme nëpër vendbanime që kanë me trafo dhe me provu me bo një lloj presioni te KEDS që investimet me shku nëpër këto vendbanime, me u rregullu trafot.P.sh. në Bllacë minimum janë tri trafo urgjente për me shku.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

24 për, 1 kundër, 4 apstenime

Miratohet pika 3.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat,e hedh në votim pikën 4 për 15 vite në shfrytëzim.

18 për, 9 kundër, 1 apstenim

Miratohet Pika 4

Laureta Tafaj - kërkon të ndërprehet seanca dhe të vazhdohet një ditë tjetër për shkak të ndërprejes së rrymës dhe mos transmetimit të seancës.

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-aloimin e mjeteve nga fondi burimor (38),Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2022 në projektet kapitale ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Fadil Hoxha - përshëndet të pranishmit.Ky vendim është aprovu një here dhe ka kalu nëpër këtë procedurë,mirëpo defekti i këtij vendimi është te projektet me bashkëfinancim.Pas debateve që kemi pas me email,nuk kanë dhënë arsytim që kemi të drejtë mi pas dy nënprograme.Jemi detyru mi pru prap dhe me thane që projektet me bashkëfinancim me kalu te shërbimet publike.Nuk ka asgjë tjetër sepse i njeiti është aprovu.Projekti për ndërtimin dhe rregullimin e Koletorit në rrugën “Skënderbeu” është aprovu dhe lënda është në thesar,edhe ministri e ka nënshkru,mirëpo më kanë sugjeru që patjetër duhet me pru një vendim të Asamblesë që projektet me bashkëdinancim mi qu te shërbimet publike.Ne kemi qenë të detyeuar me bo në këtë formë dhe e juaja është me votu ose mos me votu.

Urim Suka - sot po diskutojmë për ri-alokimin e mjeteve,por ju duhet me ditë një fakt.Fakti është se është hera e tretë që po merrem me planifikimin e buxhetit dhe ende s’e kemi kry.Pra,kjo qeverisje po tregon paaftësinë e vet për me bo planifikim të buxhetit.Unë përderisa duhet me qu dorën,unë duhet me ditë se ku po doni mi qu këto pare.145.000 projekte me bashkëfinancim,59.000 projekte me bashkëfinancim dhe 10.000 projekte me bashkëfinancim.Pjesa e 410.000 eurove që po ia merrni bujqësisë dhe po i qoni te kolektori.Projektet që janë kaq të mëdhaja nuk mundesh mi bo pa plan,pa strategji,pa debat me qytetarë.Ju e dini që atje keni marrë një peticion prej tyre dhe e dini reagimin e qytetarëve atje.Pra, për projektet që janë kaq të mëdhaja duhet mi ndjek të gjitha procedurat.Ju nuk e keni bo

asnjerën.Keni nxit reagim qytetar dhe tash po ja merrni bujqësisë dhe pi bini këtu.Qoni kah të muni,por gabim e keni.

Driton Maliqaj - përshëndet të pranishmit.Desha ti informoj të gjithë kolegët asambleist që për debate publike dhe dëgjime buxhetore komuna e Suharekës është shembull e të gjitha komunave që i ka ndjek.Gjithëashtu është shpërbly nga Ambasada Britanike për dëgjime buxhetore dhe dëgjime publike.Për rastin në fjalë që përmendi kolegu,në bibliotekën”Hajdin Berisha” është mbajt dëgjimi buxhetor,ku ka qenë projekti për Kolektorin e ujërave të zeza në rrugën”Skënderbeu” dhe të gjithë qytetarët kanë pas mundësinë me dhanë vërejtje aty.Nuk ka pas interesim për me kundërshtu këtë projekt dhe ne nuk mundemi mu lidh në interes të 10 inividëve të një peticioni,kur interesi i përgjithshëm është shumë i madh.E kemi shembull edhe sheshin,ku ka pas reagime,por sot sheshi është shembull.

Urim Suka - ajo që thotë Dritoni është në kundërshtim me atë që vet bën.Këto mjete nuk i keni planifiku mi qu me kohë në atë rrugë,projekti ka qenë 100 mijë euro.Nuk janë 10 qytetarë por janë më shumë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

14 për, 9 kundër, 1 apstenim

Miratohet Pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të Komunës ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - Prap paaftësi.I kemi bartë, ja ka kthi ministria sikurse po ja u kthen vazhdimisht.Kur e lexova dokumentin,me një tabelë aty shkruan:Administrata e arsimit 13.000 euro për mallra dhe shërbime,40.000 euro për investime kapitale. Kur i mbledh në total juve ju dalin 83.000 mijë,kuse mua më dalin 53.000.Vetëm ky fakt tregon që ju nuk jeni serioz.Duke lexuar pashë që thuhet që kjo po ndodh për shak se ministria nuk i ka pranë investimet kapitale.Tash ju investimet kapitale i keni kthi në mallra dhe shërbime dhe subvencione.Kjo është paaftësi për me pas projekte për mi qu qytetarëve.Ne jemi kundër kësaj logjike dhe do ta votojmë kundër.Ju jeni duke e ndjek rrugën e njejtë dhe uroj që në fund ka ndonjë institucion që ju kontroillon pak.

Kryesuesi - për vitin 2022 ka pas të hyra vetanake për 30 % më tepër se sa janë planifiku.

Urim Suka - ne si LDK jemi kritiku vazhdimisht se po i bartim nga 300.000 prej Kryetarit tuaj që ska pas as guximin me ardh.ndërsa ju e keni prur vendimin mi bartë 924.000 euro.

Nënkryetarja - sa i përket Kryetarit, kryetari është në pushim.Kryetari gjithmonë ka qenë i rregullt në Asamblenë Komunale.

Shefket Kolgeci - a janë këto mjete që po barten vetëm të 2021-tës, apo ka dhe 2020 dhe 2019?

Fadil Hoxha -si Zyrtar Kryesor Financiar jep sqarime për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të Komunës. Sa i përket pyetjes për bartjen e mjeteve,mjete të bartuna,mundet me pas edhe të 2019-tës,por të 2020-tës dhe 2021-tës nuk ka telashe.Te Urimi që tha po i zvoglioni projekte kapitale,në këtë rast nuk po zvogëlohen projektet kapitale por projektet kapitale janë të keqklasifikuara.Pra, për ne si organizatë buxhetore më mire është me i kthi në mallra dhe shërbime.Këto janë pozicionet tona ,që këto pjesë që kanë mbet te projektet kapitale me i destinu në këtë formë,dhe nuk kam pas zgjidhje tjetër dhe jam detyru edhe një here mi prur para jush.

Urim Suka - ai gati e konfirmoi atë që e thash unë,por përmendi edhe keqklasifikimin.

Fadil Hoxha - nëse e shohim me përqindje, ndoshta i takon prej komunave më së paku që kemi keqklasifikime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

**15 për,8 kundër,
Miratohet pika 6**

Pika 7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve për raportin e zyrës kombëtare të auditimit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - së pari e vlersoj punën e zyrtarëve që janë angazhuar në përpilimin e këtij dokumenti.Por në seancën kur kemi diskutuar për raportin e auditimit, pothuaj në secilin fjalim tonin ju keni dhënë arsyetimet e juaja të pa baza, se nuk qëndrojnë ato që i themi ne.Shqetësimi mbetet zbatimi i këtij plani.A do të zabtohen veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë sipas këtij plani të veprimit? E them me keqardhje,jo ,dhe këtë e dëshmoj kështu: Ky plan është përpiluar me 7 korri 2022 dhe është protokoluar po atë ditë dhe janë gati dy muaj kur ju i keni thënë zyrës së auditimit se do të ndermerrni hapa konkret se si do ti përmirësoni vërejtjet.Por ju nuk po e zabtoni këtë plan veprimi,sepse tek çështja A3-Moshartimi i projekteve ekzekutive për projekte kapitale ,ju i jeni përgjigjur: që përpos specifikimeve teknike do të përgadisni edhe një projekt ekzekutues.Të gjitha këto veprime keni thënë se do ti relizoni para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit.Realisht ju në pjesën më të madhe të procedurave të prokurimit të shpallura pas kësaj date i keni inicuar pa projekte. Kërkoj që tani e tutje jo vetëm për shkak të raportit të auditimit por edhe me qëllim që investimet të bëhen me standarte e norma teknike, për të njejtat të përpilohen projekte.

Urim Suka - ju plane nganjëherë po bëni ose pi merrni kopi paste, por kur po doni mi implementu në teren i boni në logjikën e juaj, sikurse që e kam ngrit çështjen e investimeve me ndriçim publik.Problemi i raportit nuk është që ju ndoshta skeni plane por skeni vullnet mi ndal keqpërdorimet.

Nënkryetarja - mendoj që seancën e kaluar është fol mjaft për këto rekomandime. Keqklasifikimet ndodhin në mungesë të një kodi të veçantë buxhetor.Shumë here kemi pas telashe edhe me punëtorët e karitasit,ku këtë here auditori e ka vendos si keqklasifikim për arsye se janë paguar nga mallra dhe shërbime.E rëndësishme është mos me pas keqpërdorim.

Labinot Halitjaha - sa i përket rekomandimeve, unë kam qenë vet në zyrën e auditimit dhe i kemi diskutu këto 11 pika që nuk kanë dal mire si kualifikim, por Komuna e Suharekës nuk ka dal edhe keq.Tash vitin 2022 ne veq e kemi marrë buxhetin i cila ka ardh me vonesë.Një pjesë të madhe të rekomandimeve i kemi shqyrtu dhe pjesa ma e madhe nuk ka me ekzistuar në vitin 2022.Drejtori jep sqarime edhe rreth regjistrimit të pasurisë.

Selman Kolgeci - te pika që thoni: po besoj që kemi me dal mire në vitin 2022, forma qysh jeni qas është në rregull por nuk jeni duke e zbatu atë.Keni thënë që për secilin tender kemi me bo projekt, por mbas datës 7 korrik i keni inicuar pa projekt.

Besa Kuçi - Drejtoria e shëndetësisë ka inventar të paregjistruar. Dua të sqaroj që çdo inventar është regjistru në tabelë, por vazhdimisht kemi pas problem me qasje, ku pjesa e kodit ka mungu për shkak se punëtori ka dal në pension. Drejtoresha tutje jep sqarime dhe thotë që në momentin që jepet qasja dhe vje punëtori atëherë do të merrem vet me këtë qështje sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë.

Urim Suka - vullneti për me bo ndryshime është i madh nga ana jonë. Ne kemi dëshirë plani i veprimit mu implemenetu, por tash është vonë sepse ky vit veq ka shku.

Labinot Halitjaha - sa i përket keqklasifikimeve, çdo projekt kapital që nuk e ka pas emrin ndërtim, e kanë kthi prap.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Kushtrim Kuçi - Kam disa kërkesa prej qytetarëve dhe disa vërejtje dhe sugjerime të miat. 1. Rrethrotullimi te shkolla fillore "Destan Bajraktari" ka 6-7 muaj që ka mbet i cungun, kërkoj sqarime. 2. Te shtëpia e Felbahut, mirëmbajtja komomurative nuk ka klimatizim. A mundeni si Komunë me reagu në këtë drejtim? 3. Sugjeroj që te lagjja Gradina, te Bajraktarët mu vendos një rrethrotullim ose një polic i vdekur dhe gjithëashtu qytetarët kanë kërku që mbeturinat të barten dy herë në javë në atë lagje. 4. A ka mundësi me u vendos ndriçimi nëpër fushat e sportit, të shkollave: gjimnazi "Jeta e Re", "Destan Bajraktari" dhe "7 Marsi". 5. Qyteti muk ka ujë, mendoj që Komuna duhet me bo diçka. 6. Pjesa e rrafshët e Peqanit kanë ujë, por nuk po lejojnë me vendos njehsor, ndërsa pjesa ku fshati është në formë bregu, nuk ka ujë. Nuk po reagon Komuna, intitucioni, policia.

Enver Shabani - rrethrotullimi te Destan Bajraktari, vërtetë është keq, por ne nuk kemi udhëheq ndonjë procedure ose tender, më shumë është një lloj donacioni. Operatori ekonomikë ka marrë shumë punë dhe nuk po arrin ti kryej. Sa i përket mbeturinave, në Suharekë mbeturinat mblidhen pothuaj çdo ditë, ndërsa nëpër lagje dhe fshatra mblidhen një here në javë. Sa i përket ndriçimit, ne kemi fillu ngapak me ndriçime si në Sopijë dhe Bukosh etj.

Kushtrim Kuçi - mire që keni investu prap, por qëllimi është në fushat e sportit në Suharekë.

Enver Shabani - mundemi me i bo me reflektor, por me i shfrytëzu kur është e nevojshme. Te hidroregjioni , vitin e kalum ne kemi bo investime me tre rezervuar me ujë. Ujë ka mjaftueshëm por ka keqpërdorime. Për me i eliminu keqpërdorimet, Komuna këtë vit ka nda 95.000 euro me bashkëfinancim me Hidroregjionin. Peqani ka ujë, por problemi është brenda banorëve. Sa i përket rrethrotullimit në Gradina, ekspertët e urbanizmit dhe të komunikacionit le ta sjellin një plan-projekt dhe ne si drejtori nese gjejmë mjete mundemi me bo ekzekutimin.

Shefket Kolgeci - ndoshat jeni në dijeni, në Vraniq qytetarët janë detyru me shtru rrugë vet, dhe nuk iu ka dal në ndihmë komuna. Ajo rrugë nuk është rrugë lokale, nuk është rrugë personale por është një ndër rrugët ma të vjetra të fshatit Vraniq. Problem aty është vendosja e një muri, rreth 50 m. Kërkoj arsyetim për këtë.

Enver Shabani - ne e kemi informatën, ka ardh personi në fajllë dhe ka thënë që jemi të gatshëm me shtru rrugën me kompaninë që ka qenë duke i kry punët në Vraniq. Rruga nuk ka pas prioritet për disa arsye dhe njëra ndër arsyet është ajo që e the, muri mbrojtës.

Shefket Kolgeci - nuk qëndron kjo. Ju është thënë që nuk jeni në programin e komunës për këtë rrugë.

Urim Suka - unë kam pas shqetësime të shumta të qytetarëve.Në mbledhjen e kaluar unë kam kërku nga Drejtoria e Kulturës me na përgadit një raport për shpenzimet e 13 Qershorit dhe për subvencione.Atë raport unë nuk e kam marrë,përkundër që zyrtari ligjor i ka dhënë të drejtë kërkesës sime dhe përkundër që Kryesuesi i ka kërku specifikisht Drejtoreshës që me përgatit raportin.Qasja e këtij pushteti mos me ja dhënë asnjë raport minimal asambleistit është për me të ardh keq.Ju lus ta adresoni te Kryetari juaj sepse kjo nuk bën mi ndodh Asamblesë Komunale. Pyetje për Drejtorin e Arsimit: 1.Cilat janë përgaditjet që i ka bërë DKA-ja që ky proces me fillu sa ma mbarë? 2. A janë rekreutu mësimdhënësit për mungesat për vendet e lira që kanë qenë? 3. Janë një numër i kontratave për meremtimin e shkollave dhe për çudi janë të nënshkruara tash vonë.A kanë përfundu punët nëpër ato shkolla? Nëse s'kanë përfundu, a ka naj shkollë që nesër nuk mundet me fillu procesin?

Lorika Gashi - raporti ka ardh.Ta kam kërku një kërkesë me shkrim dhe nuk ka pas kërkesë me shkrim.E ke bo kërkesën në Asamble dhe raporti ka ardhë në Asamble.Drejtoresha lexon raportin.

Remzi Bajselmani - përshëndet të pranishmit.Për çështjet që ngriti asambleisti, rekreutimi i Mësimdhënësve është duke u bë, sot përfundojnë intervistat me gojë dhe dalin rezultatet deri të premtën. Sa i përket punimeve,është e vërtetë që janë nënshkru me vonesë.Por ne,pengesë kemi vetëm në shkollën gjimnazi “Jeta e Re”,i cili është projekt i Ministrisë së Arsimit dhe ajo na pengon vetëm dy ditë sipas marrëveshjes që kemi ,kurse punët që janë duke u kry në shkolla tjera nuk e pengojnë fillimin e procesit mësimor.

Selman Kolgeci - Kërkesë për Drejtorinë e Administratës: -Afati i fundit për pranimin e kërkesave për legalizimin e objekteve përfundon me 4 shtator, që i bie ditë e diel.Pasi shërbyesit civil ndodhen në grevë, kërkoj mirëkuptimin dhe kërkoj që të pranojnë kërkesa edhe ditën e shtunë edhe ditën e hënë.

Kërkesë për Kryesuesin: -Kërkoj që çoftë me Drejtorinë e Kulturës apo individualisht me gjet forma për një gjenerator për me transmetu seancën.

Kymete Bjaraktari - Drejtoria e Administartës deri dje kanë punu sidomos zyra e pranimi dhe te qertifikatat prej dje kanë hy në grevë.Kjo kërkesë kish me u realize sikur të ishin rrethanat e zakonshme mirëpo tash ata janë në grevë.

Selman Kolgeci - do të ishte mire me i dhanë mundësi qytetarëve,me bisedu me drejtorinë e Pronës,me Drejtorinë e Urbanizmit në mënyrë që me i dorëzu kërkesat.

Armend Krasniqi - sa i përket kompetencave të Drejtorit, të Kryetarit dhe të Kryeministrit dhe çdo organizate politike, nuk kanë të drejtë me ndërhy në punën e punëtorëve të Komunës.

Kryesuesi - mië e ceke punën e gjeneratorit.Gjeneratorin e kemi por është i vjetër dhe duhet me intervenu në mënyrë manuale.

Takimi përfundoi: 11:40

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj